



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **66/2024**

Data: **03 Dhjetor, 2024.**

Vendi: **Procedure qarkulluese e mbledhjes**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Raport i Këshillave të KQZ

2.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

2.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për "Takim pune për hartimin e Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2025"

2.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

2.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për projektin " Takim pune për hartimin e Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2025".

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Mbledhja e radhë, nr. 66/2024 është realizuar në distancë - me procedurë qarkulluese përmes emailave. Anëtarët e KQZ-së, për shkak të agjendave të tyre operacionale të lidhura me proceset e aorganizimit të zgjedhjeve për Kuvend Qendror që do të mbahen me 9 shkurt, 2025, janë dakorduar për këtë mënyrë të takimit.

Pikat e rendit të ditës të këtij takimi në distancë, janë miratuar nga anëtarët e KQZ-së në pajtim me autorizimet e dhëna me 59, dhe nenin 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 21 të Rregullores së Punës së KQZ, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për “Takim pune për hartimin e Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2025”:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar Planin Strategjik për periudhën 2023-2026. Me qëllim hartimin e një plani konkret të aktiviteteve për vitin 2025, KQZ organizon këtë takim pune me temën “Hartimi i Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2025”. Ky takim, planifikohet të mbahet nga data 12, deri më 15 dhjetor 2024.

Në kontekst, është miratuar mbajtja e punëtorisë dhe është autorizuar Sekretariati i KQZ-së, që t’i fillojë përgatitjet për organizimin e këtij takimi.

3. Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për projektin “ Takim pune për hartimin e Planit të Punës të KQZ-së për vitin 2025”:

Në kontekst të shqyrtimit dhe miratimit të pikës së parë, është vazhduar me pikën e dytë lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit lidhur me mbajtjen e kësaj punëtorie. Përgjatë miratimit, autorizuar Sekretariati i KQZ-së, që t’i fillojë përgatitjet për organizimin e këtij takimi.

4.Të ndryshme!

Kanë votuar:

1. **Kreshnik Radoniqi:** Votoj PER miratimin e dy pikave te propozuara.
2. **Illir Gashi:** Votoj PER dy pikat e propozuara.
3. **Alban Krasniqi:** Votoj PER te dy pikat e propozuara.
4. **Arianit Elshani:** Votoj PER miratim te rekomandimeve te Keshillave
5. **Sami Kurteshi:** Unë votoj PËR të 2 pikat e propozuara.
6. **Sami Hamiti:** Votoj PËR rekomandimet!
7. **Ibrahim Selmanaj:** Votoj PER dy pikat e propozuara.
8. **Mufera Shinik:** Votoj PER te 2 pikat e propozuara.
9. **Fazli Stollaj:** Votoj PËR të dy propozimet
10. **Gordana Llaban:** Të nderuar kolegë, votoj për të dy propozimet.
11. Qemal Kurtis: Votoj për këto propozime.